Numri 6 Maj–Qershor 2018

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

UniVlora Newsletter

Përmbajtja:

Vizitë e Rektorit të UV në Pekin f.2

Konferenca e 5-të Shkencore Ndërkombëtare ne Strugë "Sfidat Shkencore për Zhvillimin e Qëndrueshëm" f.3

Takim me Ambasadoren Greke në Republikën e Shqipërisë, Shkëlqesinë e saj Znj. Eleni Sourani dhe Zv. Ambasadorin Z. Grigoris Delavekouras f.4

Seminar "Menaxhimi i Mbetjeve Spitalore dhe Ndikimi i Rreziqeve Profesionale në Mirëqënie f. 5

SEMINAR TRAINUES "Parandalimi i Melanomës - mbrojtja efektive e shëndetit tuaj" f.6

Konferenca e parë Ndërkombëtare e Infermierisë, nga Kolegji Heimerer dhe Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale në partneritet me Fakultetin e Shëndetit Publik f.7

Konferencën e tretë ndërkombëtare me temë: "Language, Culture and Community: 21st-Century Perspectives." f.8

Aktivitet me rastin e 1 Qershorit f.9

JEPI NJE DORE JETES, DHURO GJAK f.10

Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Prof. Dr Roland Zisi, nderohet nga BFSU me titullin akademik "Distinguished Research Fellow"

Me ftesë të Prof. Dr Peng Long, Presidentit të BFSU-së (Beijing Foreign Studies University), Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Prof. Dr Roland Zisi, kreu një vizitë pune një javore në Pekin (Kinë) …f.2

Konferenca e 5-të Shkencore Ndërkombëtare ne Strugë

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor, Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Prof. Dr. Roland Zisi më datë 19 Maj 2018, mori pjesë në Konferencën e 5-të Shkencore Ndërkombëtare me tematikë "Sfidat Shkencore për Zhvillimin e Qëndrueshëm", zhvilluar në Strugë dhe organizuar prej Universitetit Ndërkombëtar të Strugës në bashkpunim me Universitetin e Vlorës dhe Universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit. ….. f3.

REKTORI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË, PROF. DR ROLAND ZISI, NDEROHET NGA BFSU ME TITULLIN AKADEMIK *"DISTINGUISHED RESEARCH FELLOW"*

Me ftesë të Prof. Dr Peng Long, Presidentit të BFSU-së (Beijing Foreign Studies University), Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Prof. Dr Roland Zisi, kreu një vizitë pune një javore në Pekin (Kinë). Vizita u organizua në funksion të progresit të mëtejshëm të marrëveshjes dypalëshe mes dy universiteteve, nënshkruar një vit më parë, si dhe të pjesëmarrjes së tij në "Symposium on China-Balkan cooperation in the contekst of 'Belt and Road' initiative", organizuar nga Balkan Studies Center, Beijing Foreign Studies University.

Rektori i UV-së Prof. Roland Zisi u prit në takime zyrtare e miqësore fillimisht nga rektori Peng Long, dhe më pas nga drejtoresha e marrëdhënieve me jashtë dhe albanologia e shquar kineze, Prof. dr. Ke Jing, nga shefja e departamentit të Gjuhes dhe Letersisë shqipe në BFSU, Dr. Fenghua Chen si dhe nga kolegë të tjerë kinezë të këtij departamenti.

Në këto takime u bisedua per gjetjen e formave dhe mënyrave efikase të bashkëpunimit midis dy universiteteve dhe në veçanti mes dy departamenteve që zhvillojne programe studimi në fushë të gjuhës dhe letërsisë shqipe e ballkanike, si dhe per organizimin në të ardhmen të veprimtarive të përbashkëta shkencore, akademike, botuese e pedagogjike.

Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Prof. Dr Roland Zisi, mori pjesë në "Symposium on China-Balkan cooperation in the contekst of 'Belt and Road' initiative", organizuar nga Balkan Studies Center, Beijing Foreign Studies University. Si autor i dytë, sëbashku me Prof. Dr Shaban Sinani (autor i parë), ai prezantoi, në këtë aktivitet të rëndësishëm akademik, kumtesën me titull "How Many Balkans Are There?", në të cilën trajtoheshin zhvillimet aktuale në vendet e Ballkanit, realitetet e reja politike, sociale e kulturore në to si dhe perspektivat e qasjeve bashkëkohore mes tyre.

Në këtë simpozium merrnin pjesë ekspertë studiues nga disa universitete kineze dhe vendeve ballkanike, studiues të tjerë nga vende të ndryshme të botës si dhe përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Ballkanit. Ishte i pranishëm edhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kinë, z. Selim Belortaja.

Në pjesën e parë ceremoniale të këtij simpoziumi, rektori i BFSU-së, Prof. Peng Long, u dorëzoi Prof. Shaban Sinanit dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Prof. Dr Roland Zisi, titullin akademik "Distinguished Research Fellow", nderim që nënkupton, sipas legjislacionit universitar të atjeshëm, emërimin e tyre si partner/bashkëpunëtor të Qendrës së Studimeve Ballkanike të BFSU-së, për hulumtime shkencore në këtë fushë.

Në një nga ditët e qëndrimit në BFSU, Prof. Zisi zhvilloi një takim me studentët kinezë që ndjekin programin e studimit të gjuhës shqipe duke iu përgjigjur interesit dhe kureshtjes së tyre për zhvillimet bashkëkohore letrare e kulturore shqiptare e ballkanike.

Gjithashtu Prof. Zisi, në cilësinë e anëtarit të jurisë, ishte pjesëmarrës në mbrojtjen e gradës shkencore Doctor, të disertantes kineze Ma Sai, me tezën e studimit krahasues të veprave letrare të Ivo Andriç dhe Ismail Kadare.

KONFERENCA E 5-TË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE NE STRUGË "SFIDAT SHKENCORE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM"

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor, Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Prof. Dr. Roland Zisi në datë 19 Maj 2018, mori pjesë në Konferencën e 5-të Shkencore Ndërkombëtare me tematikë "Sfidat Shkencore për Zhvillimin e Qëndrueshëm", zhvilluar në Strugë dhe organizuar prej Universitetit Ndërkombëtar të Strugës në bashkpunim me Universitetin e Vlorës dhe Universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit. Rektori i Universitetit të Vlorës Prof. Dr. Roland Zisi, nën cilësinë edhe të bashkëkryetarit të konferencës vendosi theksin në rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar të institucioneve të arsimit të lartë dhe të kërkuesve shkencorë, për një zhvilllim të qëndrueshëm të rajonit dhe më gjerë. Po ashtu theksoi bashkëpunimin e mirë që Universiteti i Vlores ka ndërtuar me Universitetin e Struges. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë si bashkëpunëtor organizativ i konferencës shkencore, u përfaqësua edhe me zv. Rektorin per Kerkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional PhD Enkelejd Mëhilli si dhe një sërë punimesh shkencore në fusha të ndryshme prej pedagogëve të tij.

Takim me Ambasadoren Greke në Republikën e Shqipërisë, Shkëlqesinë e saj Znj. Eleni Sourani dhe Zv. Ambasadorin Z. Grigoris Delavekouras

Në vazhdimësinë e bashkëpunimit shumëdimensional midis Universitetit " Ismail Qemali" Vlorë dhe Ambasadës Greke në Shqipëri, më datë 04.06.2018 Rektori Prof. Dr. Roland Zisi mirëpriti në mjediset e Universitetit, Ambasadoren Greke në Republikën e Shqipërisë, Shkëlqesinë e saj Znj. Eleni Sourani dhe Zv. Ambasadorin Z. Grigoris Delavekouras.

Të pranishëm në takim ishin studentë të cilët, me mbështetjen e Ambasadës Greke në Tiranë, prej datës 26.03.2018 deri më 29.03.2018, vizituan Universitetin "Aristotelio" të Selanikut. Takimi u organizua në trajtën e një diskutimi të hapur ku studentët përshkruan eksperincën e tyre gjatë vizitës kërkimore jo vetëm në mjediset e Universitetit por edhe në zona të ndryshme historike dhe arkeologjike të qytetit, duke i dhënë edhe një dimension kulturor shkëmbimit studimor.

Ambasadorja Znj. Eleni Sourani përshëndeti veçanërisht dy studentët e Universitetit " Ismail Qemali" Vlorë, fitues të bursave studimore të financuara prej Ambasadës Greke në Shqipëri. Prof. Dr Roland Zisi, ashtu sikurse edhe Ambasadorja i cilësuan si të sukseshme aktivitetiet e realizuara deri më tani duke u angazhuar jo vetëm në riorganizimin e tyre për vitin e ardhshëm por edhe në ndërmarrjen e nismave të reja.

Seminar “Menaxhimi i Mbetjeve Spitalore dhe Ndikimi i Rreziqeve Profesionale në Mirëqënie”

Seminarit – Trajnues me temë: “Menaxhimi i Mbetjeve Spitalore dhe Ndikimi i Rreziqeve Profesionale në Mirëqënie”



Në kuadër të ditës ndërkombëtare të shëndetit dhe sigurisë në punë 28 prill, Fakulteti i Shëndetit Publik, Departamenti i Infermierisë organizoi Seminarin- Trajnues me temë: ” Menaxhimi i Mbetjeve Spitalore dhe Ndikimi i Rreziqeve Profesionale në Mirëqënie”, me koordinator Denada Selfo dhe grup pune Vitori Hasani, Majlinda Zahaj, Brunilda Subashi, Rozeta Luci .

Seminari kishte si qëllim rritjen e njohurive të profesionistëve të shëndetit lidhur me menaxhimin e mbetjeve spitalore, faktorëve të rrezikut në punë, sigurinë dhe aspektin ligjor si dhe parandalimin e infeksioneve nosokomiale .

Përfitues të njohurive ishin mjek, infermier, jo vetëm të qytetit të Vlorës por edhe të qyteteve, Fier, Lushnjë, Sarandë, Tepelenë, Mallakastër .

Aktiviteti është i akredituar nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdimësi QKEV me 6 kredite. .

Seminari -Trajnues u zhvillua në Spitalin Rajonal të Vlorës, pranë ambienteve të Telemedicinës dhe do të përsëritet në datën 26 maj 2018.

SEMINAR TRAINUES
“PARANDALIMI I MELANOMËS - MBROJTJA EFEKTIVE E SHËNDETIT TUAJ”

Fakulteti i Shëndetit Publik, Qendra Studimore për Shëndetin Publik organizoi në datë 2 Qershor 2018 në Spitalin Rajonal të Vlorës, pranë ambjenteve të Telemedicinës seminarin trajnues me t e m ë “Parandalimi i Melanomës - mbrojtja efektive e s h ë n d e t i t t u a j ” Melanoma- roli i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në edukimin e komunitetit mbi rreziqet e Ca të lëkurës,me koordinator Glodiana Sinanaj dhe grup puneYllka Stramarko, Fatjona Kamberi, Brunilda Subashi, Jerina Celaj. Në këtë organizim ishte i pranishëm zv/rektori i Universitetit të Vlorës, Z.Enkelejd Mëhilli. Rritja e ndërgjegjësimit të profesionistëve të shëndetit në lidhje me këto problematika, bën të mundur aftësimin e tyre për implementimin e programeve të ndryshme, përmirësimin e protokolleve me qëllim parandalimin e melanomës. Me diagnozën, edukimin dhe këshillimin e duhur, vdekshmëria nga melanoma duhet të shmanget në individë me rrezik të lartë.

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE E INFERMIERISË, NGA KOLEGJI HEIMERER DHE INSTITUTI I EVROPËS JUGLINDORE PËR POLITIKA SHËNDETËSORE DHE SOCIALE NË PARTNERITET ME FAKULTETIN E SHËNDETIT PUBLIK, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Është zhvilluar më datë 11 Maj 2018 Konferenca e parë Ndërkombëtare e Infermierisë, nga Kolegji Heimerer dhe Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale në partneritet me Fakultetin e Shëndetit Publik, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Në këtë zhvillim i pranishëm edhe zv/rektori i Universitetit të Vlorës, Z.Enkelejd Mëhilli, i cili e cilësoi konferencën, një urë lidhëse në mes Kosovës dhe Shqipërisë, dhe një fillim i bashkëpunimit për avancimin profesional në të dy shtetet.

Në këte takim u finalizua dhe nënshkrimi i marëveshjes së bashkëpunimit nga ana e kolegjit Heimer.

Në këtë konferencë u paraqitën punime shkencore si edhe poster - prezantime, ku stafi i FSHP u paraqit me këto punimet shkencore:

- "Vlerësimi i përkujdesjes infermierore gjatë procedurës së aerosol-terapisë në moshat pediatrike" - Evis Alushi, Sonila Nika, Majlinda Zahaj, Juljana Xhindoli.
- "Faktorët që ndikojnë në zbatimin e procesit infermieror në Spitalin Rajonal të Vlorës" Rudina Çercizaj, Emirjona Kiçaj, Stiliana Brokaj
- "Ndikimi i çrregullimeve të gjirit dhe edukimit prenatal në prevalencën e vështirësive të ushqyerjes me gji tek gratë postpartum në rrethin e Vlorës" - Rezarta Lalo, Rudina Cercizaj.

Poster-prezantimet e paraqitura nga ana e FSHP ishin:

- "Kënaqësia e profesionistëve të shëndetit për aktivitetet e edukimit në vazhdim - studim kros-seksional" - Fatjona Kamberi, Yllka Stramarko, Glodiana Sinanaj, Brunilda Subashi,Rukije Merovci.
- "Ndikimi i stresit në asistencën infermierore ndaj pacientëve depresivë" - Sonila Nika, Majlinda Zahaj, Evis Alushi.
- "Përdorimi në praktikën klinike nga stafi infermieror i mekanikës së duhur trupore: Studim kros-seksional" - Gentjana Haskja, Fatjona Kamberi.
- "Roli i infermierit në implementimin e gjenetikës në përkujdesjet infermierore të Shërbimit Shëndetsor Parësor"- Denisa Aliraj, Yllka Bilushi.
- "Periudha postpartum dhe vlerësimi i punës së infermierit"- Emirjona Kiçaj, Rudina Cercizaj, Emiljana Coraj, Dritan Coraj.

Në fund të konferencës u shpërndanë edhe çmimet fituese, ku për prezantimin më të mirë u vlerësua me vendin e dytë pedagogia Evis Allushi.

Për poster-prezantimin më të mirë u vlerësuan me vendin e parë Gentjana Haskja, studente e ciklit Master Shkencor ne FSHP, dhe me vendin e tretë, Denisa Aliraj, studente e ciklit Master Shkencor, në FSHP.

Urimet më të mira fitueseve të çmimeve të konferencës për përfaqësimin dinjitoz të FSHP në këtë konferencë! Suksese të mëtejshme të gjithë pjesmarrësve!

KONFERENCËN E TRETË NDËRKOMBËTARE ME TEMË: “LANGUAGE, CULTURE AND COMMUNITY: 21ST-CENTURY PERSPECTIVES.”

Në datën 30 maj 2018, Departamenti i Gjuhëve të Huaja organizoi konferencën e tretë ndërkombëtare me temë: “Language, Culture and Community: 21st-Century Perspectives.” Kumtues vendas dhe të huaj referuan në punimet e tyre çështje të lidhura me ndryshimet dhe ndikimet që gjuha dhe, për rrjedhojë, kultura e komuniteti kanë pësuar dhe pësojnë si pasojë e ndikimeve që vijnë nga dukuri si globalizimi, teknologjia dhe lëvizjet migratore. Punimet i përkisnin fushave të ndryshme si gjuhësi, studime letrare, studime kulturore, mësimdhënie e gjuhës së huaj. Folës i ftuar në këtë konferencë ishte Dr. Julius Rozenfeld nga Pavol Jozef Safarik University in Kosice, Slovakia.

AKTIVITET ME RASTIN E 1 QERSHORIT

Me rastin e 1 Qershorit, Festës se Fëmijëve, Departamenti i Shkencave Kompjuterike ndërmori iniciativën për zhvillimin e një aktiviteti social në Shtëpinë e Foshnjës në Vlorë. Kësaj nisme ju bashkuan jo vetëm pedagogët, por edhe studentët e cikleve të studimit Bachelor dhe Master.

Në datën 31 maj, përfaqësues të Departamentit, pedagogë dhe studentë dhuruan pranë shtëpisë së foshnjës, lodra dhe ushqime, të cilat u blenë përmes fondeve të dhuruara nga studentët dhe pedagogët bashkarisht. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite, u organizua një aktivitet social me qëllim argëtimin e fëmijëve.

Fëmijët dhe Stafi i priten përfaqësuesit e Departamentit nën një atmosferë të çlirët dhe të gëzuar. Përgjatë kohës se qëndrimit me fëmijët u organizuan lojëra të ndryshme ne ambientin e parkut brenda Shtëpisë se Fëmijës. Fëmijët, në mënyre tepër rastësore, u organizuan me njëri-tjetrin duke dhëne një koncert recital me vjersha dhe këngë.

Ndonëse për ata fëmije dashuria prindërore është diçka e munguar momentalisht, ata ditën që të ndajnë dhe të japin shumë dashuri tek përfaqësuesit tanë. Atmosfera e krijuar ishte tepër pozitive, plotë ndjenjë mirësie dhe dashurie.

JEPI NJE DORE JETES, DHURO GJAK

JEPI NJË DORE JETES, DHURO GJAK. ME KËTË SLOGAN PUNONJES TË KOSULLATES SE ITALISË NË VLORË I JANË BASHKUAR NISMES PËR DHURIM VULLNETAR TË GJAKUT, PËR FEMIJET TALASEMIK TË SPITALIT TË VLORËS. KËSAJ NISME TË KONSULLATES, I JANË BASHKUAR EDHE INTELEKTUALE, PEDAGOGE TË UNIVERSITETIT TË VLORËS, "ISMAIL QEMALI", SI DHE ORGANIZATA TË NDRYSHME. KONSULLJA E ITALISË NË VLORË, LUANA MICHELI, VLERËSOI KËTË NISME SENSIBILIZUESE DHE DASHAMIRËSINE E QYTETARËVE TË VLORËS, PËR T'JU BASHKUAR NISMAVE TË TILLA PËR TË NDIHMUAR NJERËZIT NË NEVOJË.

Ndeshja e futbollit midis Universitetit tonë dhe Gazetarëve e cila u mbylle me rezultatin 2 -0.
I urojmë suksese të metejshme ekipit tonë!!!

Universiteti Ismail Qemali Vlorë

U.V. Ismail Qemali

Universiteti Ismail Qemali Vlore

univlora2

Botuar nga:
Sektori i Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore
Zyra e Kerkimit Shkencor dhe Publikimeve
Universiteti "Ismail Qemali" Vlore